



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:083773 **C. nr. 1813/2018**
Datë: 23.12.2022
Numri i dokumentit: 03795378

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit S.K. nga Prizreni, kundër të paditurve Gj.G., S.M., Sh.N., Z.A., Gj.K., S.K., R.K., S.K. dhe N.K. të gjithë nga Prizreni, për vërtetimin e pronësisë, jashtë seance, me datë 23 Dhjetor 2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padia për shkak të gjyqvarësisë – litispedences.

A r s y e t i m

Me padinë e paraqitur me datë 30 Qershor 2017 për vërtetimin e pronësisë kundër të paditurve Gj.G., S.M., Sh.N., Z.A., Gj.K., S.K., R.K., S.K. dhe N.K. ka kërkuar të vërtetohet se është pronar i ngastrës kadastrale nr. 5520-0 ZK Prizren.

Në këtë lëndë gjykata ka mbajtur disa seance, deri në momentin kur lënda tjetër me të njëjtit palë të paditura dhe për të njëjtën ngastër është kthyer nga Gjykata e Apelit në rigjykim. Ajo lëndë ndodhet në punë te gjyqtarja Edije Sezairi e cila mban numrin C. nr. 1052/2020.

Pasi që në rastin konkretë kemi të bëjmë me litispedencë, pasi që lënda e cila e mban numrin tani C. nr. 1052/2020, pasi që është kthyer në rigjykim. Për objekt shqyrtimi ka vërtetimin e pronësisë për ngastrën kadastrale nr. ZK Prizren. Ndërsa palët ndërgjyqëse janë identike me palët në lëndën C. nr. 1813/2018 me objekt të njëjtë të kërkesëpadisë.

Duke pasur parasysh se në rastin konkret kemi krijim të gjyqvarësië, gjykata në kuptim të nenit 391 të LPK-së vendosi që të hedh poshtë padinë.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 1813/2018 datë 23 Dhjetor 2022

Gj y q t a r i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate në afat prej 15 ditsh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.